



## Projekti i së ardhmes. Përtej parave politikës dhe luftes.

Nga Jacque Fresco dhe Roxanne Meadows

Ky document është një pasqyrim jo ç'fare e ardhmja do të jetë, por ç'fare ajo mund të jetë n.q.s ne zbatojme aktualisht ç'fare dimë, me qëllim që të arrijmë një qyteterim të ri botëror të qëndrueshem. Ai kërkon një rishikim të qartë të kultures tone ne të cilen mospërsosmeria dhe nevoja për luftë, varferi, uri, borxh, dhe vuajtje të panevojshme për njerëzimin shikohen jo vetem si të mënjanueshme por totalisht të papranueshme. Çdo mundim më i vogël do të rezultonte në një vazhdimësi të të njëjtit aspekt të problemeve që karakterizojne botën e sotme.

Sot pjesa më e madhe e njerëzve besojnë se një standart i lartë etik si dhe ashpërsimi i ligjeve ndërkombetare është i mjaftueshëm për arritjen e një shoqërie globale të qëndrueshme.

Por edhe sikur njerëzit me standartet etike më të larta të zgjidheshin për drejtim politik, pa të ardhura të mjaftueshme ne do kishim po të njëjtat probleme që kemi sot. Kur një grusht vendesh kontrollon pjesën më të madhe të të ardhurave botërore, dhe qëllimi i vetëm është fitimi, i njëjti cikël ngjarjesh do të mbizotroje. N.q.s ne me të vërtete dëshirojmë të zgjidhim problemet tona sociale dhe ndërkombetare ne duhet konkretisht të shpallim tokën dhe të gjithë të ardhurat prej saj si trashgimëri e të gjithë popujve të botës.

Toka është e pasur me burime të pashterëshme. Praktika jone e raziionimit të të ardhurave nëpërmjet kontrollit monetar, nuk është më aq e rëndësishme dhe e dëmshme për mbijetesën tonë. Sot ne kemi në përdorim një teknologji shumë të avancuar. Por sistemi ynë shoqëror nuk ka shkuar hap pas hapi me kapacitetin tonë teknologjik i cili është në gjendje të krijojë bollshmëri, liri nga skllavëria dhe borxhet për të gjithë. Kjo mund të kompletohet vetem me krijimin e një qytetërimi botëror bazuar në të ardhurat.

Konkretisht një sistem ekonomik i bazuar në të ardhurat, përdor burimet ekzistuese në vënd të parasë dhe krijon një metodë shpërndarje të barabartë në mënyrën më njerëzore dhe efikase për të gjithë popujt e botës. Ai është një sistem në të cilin të gjitha pasuritë dhe shërbimet janë të arritshme pa nevojën e përdorimit të parasë, kreditit, matrapazllëkut opo te ç' do loj forme tjetër borxhi ose skllavërie.

Qëllimi i këtij projekti të ri shoqëror është të nxisi një sistem të ri inçentivimi, i cili nuk është më i prirur drejt cekshmërisë dhe qëllimeve egoiste për pasurim, pronësi dhe pushtet. Keta faktorë nxitës të ri do të çojnë njerëzit drejt vetë realizimit dhe krijimtarisë si nga ana shpirtërore ashtu dhe nga ajo materiale.

Si mund të arrijmë ne nga ku jemi atje? Asnjë qeveri kurre nuk ka përfaqëuar ndryshimin shoqëror. Pushteti i vendosur ka tendencën të përtërijë vehtveten.

Fatëkeqësisht mjafton një krizë ekonomike që njerëzit të fillojnë të humbin besimin tek udheheqja dhe të kërkojnë një drejtim shoqëror alternativ.

Projekti Venus është një organizatë që propozon një plan të mundshëm për ndryshim shoqëror, që funksionon në drejtim të një qytetërimi botëror paqësor dhe të stabilizuar

Ai nënvizon një alternativë që çon atje ku të drejtat njerëzore nuk janë më të shpallura në leter por rrugë jete. Ne ju ftojme të informoheni rreth qëllimeve të këtij projekti nëpërmjet librave tonë, filmave dhe seminareve. N.q.s jeni dakort me qëllimet tona ne ju mirftojme të bashkoheni me ne në drejtim të realizimit të tij